


LIRIA E VOTËS dhe VOTIMI FAMILJAR në SHQIPËRI

Hulumtim Kombëtar
2014



Politika dhe Gratë

- **Interesi i ulët ndaj çështjeve politike apo ato të qeverisë, vihet re në shumicën e popullsisë dhe veçanërisht te gjinia femërore.** 1 në 3 të intervistuar (34%) “nuk është aspak i interesuar” ndaj politikës, ndërsa 18% e të intervistuarve shfaqin nivele shumë të ulta interesi ndaj saj (“nuk janë të interesuar”). Vetëm 18% e të anketuarve deklarojnë se janë “shumë të interesuar” në çështjet politike dhe ato të qeverisë. Ndarja sipas gjinisë nxjerr në pah se femrat janë më pak të interesuara për çështjet politikë sesa meshkujt (38% e femrave në krahasim me 29% të meshkujve pohojnë se “nuk janë aspak të interesuar”). Rreth 25% e meshkujve të intervistuar deklarojnë se janë “shumë të interesuar” në krahasim me vetëm 12% të femrave të cilat pohojnë të njëjtën gjë.



- **Angazhimi qytetar, i matur nga niveli i anëtarësimit i të intervistuarve në organizata politike apo organizata jo qeveritare, është përgjithësisht i dobët.** Vetëm 1 në 10 të intervistuar deklarohet që është anëtar i ndonjë partie politike, 1 në 30 deklarohet që është pjesë e ndonjë grupi fetar dhe një numër i papërfillshëm deklarohet se është pjesëtar i ndonjë organizate jo qeveritare. Pjesëmarrja e femrave në këto organizata është edhe më e ulët. Pothuajse 9 në 10 gra pohojnë se nuk kanë qënë asnjëherë anëtare të partive politike, krahasuar me 7 në 10 meshkuj që pohojnë të njëjtën gjë. 93% e femrave deklarojnë se nuk kanë qënë asnjëherë pjesë e ndonjë organizate jo qeveritare me fokus ndaj çështjeve të grave. Po ashtu, 95% e femrave deklarojnë se nuk kanë marrë pjesë në organizata të tjera jo qeveritare apo edhe në grupe të ndryshme në komunitet.

Anëtarësim në...	Anëtar aktual	
	Meshkuj	Femra
Parti politike	16%	6%
Grupime fetare	4%	2%
Shoqata bamirësie	0.4%	0.6%
Shoqata për gratë	0%	0.9%
OJQ	0.4%	0.3%

- **Femrat shfaqin nivele më të ulëta pjesëmarrje** përsa i përket përdorimit të instrumentave të ndryshëm për të shprehur mendimin e tyre rreth çështjeve politike apo shoqërore. Vetëm 12% e femrave deklarojnë se kanë kontaktuar me zyrtarë publik në 12 muajt e fundit, për të shprehur opinionin e tyre; vlerë kjo dy herë më e ulët se përqindja e meshkujve që deklarojnë të njëjtën gjë (25% e tyre kanë kontaktuar një zyrtar publik gjatë 12 muajve të fundit). Edhe më shqetësues është fakti që **41% e femrave deklarojnë se nuk do të kontaktonin apo vizitonin kurrë ndonjë zyrtar shtetëror** për të shprehur mendimin e tyre në lidhje me çështjet politike apo sociale, një numër ky shumë më i lartë se ai i meshkujve që pohojnë të njëjtën gjë (25%). **Përdorimi i rrjeteve sociale (Facebook, Twitter etj) për të shprehur mendime politike**

Instrumenta për të shprehur opinionin...	Nuk do ta bëja kurrë	
	Meshkuj	Femra
Kontakt ose vizitë tek një zyrtar publik	25%	41%
Përdorimi i rrjeteve sociale (Facebook, Twitter, etj.)	62%	71%
Telefonatë në një shfaqje televizive ose dërgimi i një letre drejt një gazete	56%	65%
Dërgimi i një SMS për të shprehur mendimin politik apo social	56%	65%
Dërgimi i një peticioni me shkrim ose email	55%	69%
Pjesëmarrja në protesta/ demonstrata	44%	64%

apo shoqërore është gjithashtu shumë i ulët (8% e meshkujve dhe 6% e femrave deklarojnë se i kanë përdorur këto instrumente). Peticionet, protestat/demonstratat apo edhe burimet mediatike janë ndër instrumentat më pak të përdorura për këtë qëllim.


- Megjithëse shumica e shqiptarëve do të mbështeste një pjesëmarrje më të lartë të femrave në politikë, një pjesë e konsiderueshme

e tyre, edhe midis femrave të intervistuar, mendon që “meshkujt janë udhëheqës politikë më të mirë se femrat”. 58% e meshkujve dhe 38% e femrave janë dakord me pohimin që **“meshkujt janë lidera politikë më të mirë se femrat”**. Kjo gjetje mund të sugjerojë që **ndërsa pjesëmarrja e lartë e femrave në politikë është qëndrimi i duhur politik, ky opinion nuk përkthehet në një besim të shumëpranuar nga të gjithë.**

Votimi dhe Gratë

- Në përgjithësi, **niveli i pjesëmarrësve në votime të popullatës që banon në Shqipëri është i lartë.** Pothuajse 88% e të intervistuarve deklarojnë se kanë marrë pjesë në zgjedhjet e vitit 2013. Nuk ka ndonjë diferencë domethënëse ndërmjet meshkujve dhe femrave në këtë aspekt.
- **Shumica dërmuese e të intervistuarve (93%) deklarojnë se janë ndjerë “tërësisht të lirë”** kur kanë votuar në zgjedhjet e 2013. Nuk vërehen ndryshime midis meshkujve dhe femrave në këtë aspekt. Kjo gjetje sugjeron që nuk ka pasur presion të dallueshëm, të dhunshëm ose jo, për të votuar kundër dëshirës së individit. **Megjithatë, kjo nuk do të thotë që votuesve nuk u janë premtuar favore në këmbim të votës. Në fakt, pothuajse 43% e të intervistuarve deklarojnë se janë në dijeni të rasteve në të cilat favore apo shërbime janë premtuar në këmbim të votës.** Specifikisht, hedhja e votës për “të mbajtur vendin e punës”, për “të gjetur punë pas zgjedhjeve” dhe për të “përfitur para apo dhurata” janë përmendur si **fenomene të shpeshta të hasura në më shumë se një të tretën e rasteve.**

A jeni në dijeni të ndonjë rasti ku votat janë premtuar në këmbim të ndonjë favori ?




Votimi Familjar

- Tradicionalisht familjet shqiptare i drejtohen së bashku qëndrës së votimit. Megjithatë, nga të dhënat vihet re se **“Votimi Familjar” nuk ndodh domosdoshmërisht brenda qendrave të votimit.** Ky fenomen mund të ndodhë në familje, në shtëpi, para se familjarët të drejtohen qëndrës së votimit. **Vetëm 5% e të intervistuarve pohojnë se kanë vënë re raste në të cilat Komisioni i Qendrës së Votimit ka lejuar më shumë se një person në zonën e votimit gjatë zgjedhjeve të 2013.** Megjithëse kjo është vetëm një mënyrë e përafërt për të matur fenomenin e votimit familjar (sepse ka raste që lejohen me ligj në të cilat dikush mund të hyjë i shoqëruar tek zona e fshehtë e votimit), ky numër është krahasimisht më i ulët se numri

i raportuar gjatë zgjedhjeve të kaluara (2009, 2011) apo edhe nga raportimet e paszgjedhjeve të 2013. Raporti i Monitorimit të Zgjedhjeve 2013 i OSBE për zgjedhjet e përgjithshme të atij viti tregon se **“ka pasur raste në të cilat votimi familjar/në grup është konstatuar në 13% të qendrave të votimit, veçanërisht në zonat rurale”**. Ky numër në raportin e OSBE të vitit 2011 ka qënë për **“26% e qendrave të votimit të vizituara”**. Megjithatë, këto numra nuk janë plotësisht të krahasueshme. Anketa Kombëtare e IDRA 2014 tregon për raste në të cilat qytetarët kanë hasur këtë fenomen në qendrat e votimit, kurse numri i raportuar nga misionet vëzhguese është një vrojtje kryer vetëm në **“qendrat e votimit që janë vëzhguar”**.


- Përsa i përket “votimit familjar”, janë femrat ato që më së shumti vihen nën presion nga meshkujt e familjes për të votuar në një mënyrë të caktuar. Për këtë arsye, një shifër më e drejtpërdrejtë për matjen e përafërt të “votimit familjar” do të ishte ajo e **femrave të cilat deklarojnë se janë shoqëruar nga dikush drejt kutive të votimit. Pothuajse 7% e femrave të intervistuar pohojnë se janë shoqëruar** nga një pjesëtar i familjes drejt kutive të votimit gjatë zgjedhjeve të fundit. Në 82% të atyre rasteve në të cilat ato kanë qënë të shoqëruara, shoqëruesi ka qënë zakonisht bashkëshorti ose babai.
- Kur janë pyetur për mendimin e tyre “se në çfarë mase **femrat në Shqipëri janë vënë nën presion për të votuar një parti apo kandidat të caktuar**”, gati **27% e të intervistuarve pohojnë se kjo gjë ndodh “shpesh” ose “shumë shpesh” dhe 31% pohojnë se ndodh “ndonjëherë”**. Edhe më shqetësues është mendimi i femrave të intervistuar, ku **1 në 3 prej tyre (32%) pohon se ky lloj presioni ndodh “shpesh” ose “shumë shpesh”**. Kjo gjetje është një tregues se “Votimi Familjar”, si fenomen ku meshkujt vënë nën presion pjesëtarët femra të familjes për të votuar në një mënyrë të caktuar, nuk ndodh domosdoshmërisht në ambientet e qendrave të votimit por në diskutime apo mbledhje familjare përpara ditës së zgjedhjeve.



Njohja me Kuotat Gjinore

Shqiptarët nuk janë plotësisht të informuar për qëllimin e kuotave gjinore në politikë, apo edhe për mënyrën se si ato duhet të implementohen. Vetëm 1 në 2 të anketuar është në dijeni për kushtin e vendosur ndaj partive politike, lista elektorale e së cilave duhet të përmbajë jo më pak se 30% të kandidaturave të gjinisë femërore. Të tjerët ose **nuk janë në dijeni të ekzistencës së kuotave, ose përmendin kuota të gabuara.**

Femrat janë më pak të informuara për kuotat gjinore sesa meshkujt. Vetëm 41% e femrave përmendin kuotën e saktë të përcaktuar nga ligji. Një e treta e tyre (29%) pohojnë se “nuk janë në dijeni” dhe 13% pohojnë se “nuk ka përcaktim gjinor për listat e partive politike”. Megjithatë, mbështetja për futjen e kuotave gjinore në politikë është e lartë me 83% të të intervistuarve që i mbështesin këto kuota (45% i “mbështesin fuqimisht” dhe 38% i “mbështesin deri diku”). Vetëm 9% e të anketuarve i kundërshtojnë këto kuota.



Madhësia e kampionit dhe toleranca e gabimit

Kampioni	Numri i intervistave	Periudha e terrenit	Toleranca e gabimit
Kampioni i publikut të gjerë Përfaqësues kombëtar	2000 (mbi 18 vjeç)	Nëntor - Dhjetor 2013	± 2.2% 95% interval konfidence